

Strategjia e komunikimit online publik të ISIS në Shqipëri

**(Studim i mjeteve të përdorura nga shteti islamik
për rekrutimin e luftëtarëve shqiptarë)**



Grupi organizator

- 1) Fabian Zhilla
- 2) Elena Çibuku
- 3) Irma Koplaku
- 4) Erton Graceni
- 5) Admir Malaj

Koncepti:

Një nga objektivat kryesorë të Akademisë së Studimeve Politike, është të aftësojë pjesëmarrësit në organizimin e diskutimeve publike, me qëllim nxitjen e debateve konstruktive mbi çështje të rëndësishme për shoqërinë shqiptare.

Në këtë kontekst në vlerësuam se ka një mungesë vëmendjeje për sa i përket një fenomeni të ri, që është qasja e komunikimit publik të ISIS për radikalizimin dhe rekrutimin e shqiptarëve.

Me këtë dokument ne kërkojmë të hapim një debat informues të ndërtuar mbi një studim të shkurtër mbi format e komunikimit publik që ISIS përdor për rekrutimin dhe radikalizimin e shqiptarëve.

Duke pasur parasysh hapësirën e madhe dhe mundësi që komunikimi *online* jep për organizatat terroriste, ne jemi të mendimit se kjo çështje kërkon vëmendje të veçantë dhe kërkon të adresohet dhe diskutohet nga aktorët publikë.

Takimi i nivelit të lartë i Ballkanit i mbajtur në Tiranë këtë vit ishte një forum pozitiv, që shërbeu për të dhënë ide dhe identifikuar ekspertë, gjithsesi akoma duhet një strategji të qartë nga Qeveria Shqiptare për të këtëçështje.

Struktura e Diskutimit:

- Prezantimi i analizës tonë;
- Pyetje analitike për diskutim;
- Rekomandime

Produkte:

1. *Policy Paper* (duke përfshirë sugjerimet e pjesëmarrësve);
2. Diskutim në grup;
3. Artikuj dhe analizë në media (opsionale).

Metodologjia:

Dokumenti është bazuar në dy burime kryesore, gazeta dhe përmbajtje *online*. Fillimisht janë analizuar disa aspekt të strategjisë së komunikimit publik dhe përmbajtjes së komunikimit publik që përdor ISIS në përgjithësi. Ne analizuam mbi 270 mesazhe të faqeve propagandistike online në gjuhën shqipe, ose të përkthyer në gjuhën shqipe në Facebook apo platforma të tjera online gjatë 3 muajve të fundit.

Ne aplikuar metodologjinë e analizës së përmbajtjes për të kuptuar narrativën, grupin e shenjëstruar në Shqipëri dhe platformën elektronike të përdorur. Mbledhja e të dhënave është bërë në periudhën Qershor-Shtator 2015. Ne huazuam përkufizimin Mc Farlane për çfarë përbën një video të dhunshme ekstremiste *online* që shpërndan përmbajtje për të bindur dhe radikalizuar individët në ekstremizëm të dhunshëm.

Mc Farlane (2010) përcakton se ekstremizëm i dhunshëm *online* do të thotë “përdorimi i sistemeve të komunikimit *online* si mjet për shtyrjen dhe/ose influencimin e individëve dhe grupeve për të zhvilluar, adaptuar dhe/ose avancuar sisteme besimi që shtrihen jashtë normave të pranuar nga shoqëria, duke rezultuar në mbështetjen e kërcënimeve dhe/ose akte fizike të dhunës për të përhapur këtë sistem besimi”¹.

Kjo analizë do t’u prezantohet pjesëmarrësve, duke ngritur disa pyetje për diskutim. Ndërmjet të ftuarve do të ketë ekspertë, përfaqësues të pushtetit qendror, legjislativ, prokurorisë, policisë, akademisë, shoqërisë civile, komuniteteve të besimit dhe komunitetit ndërkombëtar.

Të gjitha sugjerimet do të regjistrohen dhe do të bashkangjiten në dokumentin që do të publikohet nga Akademia. Do të diskutohen disa video dhe mesazhe *online* të ISIS për shqiptarët por dhe videot e tjera promovionale të shqiptarëve që luftojnë atje.

¹Mc Farlane B (2010) “Online Violent Radicalisation (OVer): Challenges facing Law Enforcement Agencies and Policy Stakeholders” Global Terrorism Research Centre and Politics, Department Monash University, accessed at: <http://artsonline.monash.edu.au/radicalisation/files/2013/03/conference-2010-online-violent-radicalisation-bm.pdf>, on 11/10/2015.

Të gjitha sugjerimet do të mbahen shënim dhe do t'i bashkangjiten punimit i cili më pas do të publikohet *online* në faqen e ASP, si dhe do t'i paraqitet institucioneve dhe strukturave përgjegjëse për sigurinë kombëtare si Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, Kryeministrisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit Informativ Shtetëror.

Gjithashtu ky dokument do t'i dërgohet edhe mbajtësve të interesit, apo atyre aktorëve të cilët kanë potencialin në territor, për të dhënë kudërmesazhet më efikase.

Kontekst:

Ekstremizmi fetar mbetet sfidë për vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Ndërsa me fundin e Al Qaeda shumë menduam se rebelimet e ekstremizmit fetar do të marginalizohen, ky skenar duket i pambështetur në evidenca.

Rasti i të ashtëquajturit Shteti Islamik dhe i Irakut dhe al-Sham (ISIS) në fakt tregon se dhe këto grupe të armatosura janë zgjeruar tashmë. Njëçështje shqetësuese është se shumë luftëtarë të huaj vijnë nga perëndimi dhe bashkohen me ISIS, në numër më të madh se në raste të tjera.

Bazuar në burimet e shërbimeve të inteligjencës së SHBA, masa e luftëtarëve të huaj që janë bashkuar me ISIS përbën 50% të të gjithë forcave (16,000 – 20,000) prej 31,000 total².

Luftëtarët vijnë nga më shumë se 80 vënde, përfshirë vënde si SHBA, Mbretëri e Bashkuar, Gjermani, Francë dhe vënde të vogla si Shqipëria dhe Kosova³. Numri i shqiptarëve të angazhuar në të vetë-quajturin Shteti Islamik i Irakut dhe Levantit (ISIS) është domëthënës duke marrëparasysh numrin e individëve të cilët janë bashkuar me këtë organizatë në bazë të popullsisë, krahasuar me vënde të tjera të Evropës.⁴

²<http://www.odwyerpr.com/story/public/4155/2015-03-03/confronting-isis-ultimate-pr-challenge.html>

³<http://www.theguardian.com/world/2014/oct/30/foreign-jihadist-iraq-syria-unprecedented-un-isis>

⁴Louisa Loveluck "where do its fighters come from?", Telegraph, 8 Qershor 2015, e aksesuar nga:
<http://www.telegraph.co.uk/news/worldnews/islamic-state/11660487/Islamic-State-one-year-on-Where-do-its-fighters-come-from.html>

train the new generation of leaders

Bazuar në informacionin e Kombeve të Bashkuara, rekrutuesit vinë nga vënde që nuk njiheshin për të qenë si *hot spots* për ekstremizëm të shunshëm më parë⁵.

Në kontrast me Al Qaida, e cila ishte strukturë e lëvizshme pa një territor fiks, hierarki, e fshehur dhe me një *modus operanti* si luftëtar, ISIS vepron hapur, e armatosur rëndë, me forca të rregullta dhe me sulme të orkestruara nga një “qeveri shteti”.

Richard Nicolazzo vëren “grupe të përziera si ISIS mbështeten në mjete krahasimisht të zakonshme komunikimi (dhe tani deri diku të mistershme) ... takime në fshatra, mitingje, fletëpalosje, gazeta, radio, televizion, etj.

Në diferencë me grupet e mëparshme të armatosura, ISIS veçohet në mënyrë të suksesshme për përdorimin e propagandës *online* për rekrutimin dhe përçimin e mesazheve në publik. Në 2014 një artikull i Neë York Times hidhte dritë mbi numrin e madh të ndjekësve në rrjet të ISIS. Numri i përgjithshëm i ndjekësve në Tëitër ishte 2 milion dhe 200 mijë vinin nga lidhja Arabe e Tëitër⁶.

Nicolazzo nënvizon se “Sot interneti është bërë platformë e menjëhershme globale e propagandës për ISIS, për të shpërndarë mesazhe urrejtje dhe vrasjesh”⁷.

Pjesë e strategjisë së marrëdhënieve me publikun të ISIS është dhe përdorimi i mesazheve video të dhunshme dhe fotografive me imazhe të rënda, me qëllim radikalizimin e ndjekësve, por gjithashtu edhe për t’u bërë tërheqës dhe treguar i fortë.

Mediat globale dhe komuniteti ndërkombëtar janë përpjekur të tregojnë anën e errët të ISIS, gjithsesi, rekrutimi i luftëtarëve të huaj vazhdon me ritme në rritje. Afërsisht 15,000 luftëtarë u rekrutuan në vetëm tre muaj.

Kjo përgjigjë e paprecedentë ndaj thirrjes së një grupi militant i detyrohet përgjithësisht efiçencës së marrëdhënieve të tyre me publikun⁸.

⁵<http://www.theguardian.com/world/2014/oct/30/foreign-jihadist-iraq-syria-unprecedented-un-isis>

⁶http://www.nytimes.com/2014/09/27/world/middleeast/us-vividly-rebuts-isis-propaganda-on-arab-social-media.html?_r=0

⁷<http://www.odwyerpr.com/story/public/4155/2015-03-03/confronting-isis-ultimate-pr-challenge.html>

train the new generation of leaders

Cilësia e këtyre punimeve është për t'u thënë se ka cilësi të mirë, duke pasur parasysh përpjekjet dhe ekspertizën e organizatorëve. Në pjesën vijuese të punës tonë ne fokusohmi në një analizë të shkurtër të strategjisë së marrëdhënieve në publik *online* të ISIS në Shqipëri.

Shkalla e fenomenit në Ballkanin Prëndimor:

Ka përafërsisht 600 deri 700 luftëtarë të huaj nga Ballkani Perëndimor (Shqipëri, Kosovë, Serbi, Mal i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Maqedoni) të cilët kanë udhëtuar nga Siria në Irak ndërmjet 2012 dhe 2015 (Shtuni 2015a).

Pjesa më e madhe janë shqiptarë etnik, të cilët me përafërsisht 500 individë, përbëjnë gati 80% të luftëtarëve nga këto zona (Shtuni 2015b).

Ndërkohë, edhe pse nuk ka siguri për panoramën e saktë, duke u mbështetur në burimet publike të informacionit, numri i shqiptarëve nga Shqipëria varion nga 90 deri në 148. Në Kosovë ky numër mund të jetë dyfish. Mbështetur në intervistën e Ministrit Kosovar të Punëve të Brendshme në Zërin e Amerikës, ky numër ishte 300 në 20 Shkurt 2015⁹.

Numri i individëve të arrestuar dhe të lidhur me grupet ekstremiste në Lindjen e Mesme është gjithaashtu i lartë në Shqipëri dhe Kosovë. Në Mars 2014, 13 individë u arrestuan në Shqipëri në lidhje me akuzën për rekrutimin e 70 individëve për t'u bashkuar me Jabhat al-Nusra dhe më vonë me ISIS, 9 prej tyre po gjykohen nga Gjykata e Krimeve të Rënda (Spahiu 2015).

Në Kosovë ky numër është dhe më i madh. Nga 2013 janë arrestuar 80 individë me akuzën për ndihmën dhe mbështetjen për ISIS¹⁰, ku 5 janë arrestuar në 11 Qershor 2015¹¹.

⁸<https://www.bellingcat.com/neës/mena/2015/02/11/how-the-islamic-states-massive-pr-campaign-single-handedly-secured-its-rise/>

⁹Interview with Skender Hyseni, Kosovo's Minister of Internal Affairs (Intervistë me Skender Hysenin, Ministreri Brendshëm i Kosovës). Voice of America (Albania), 20 February 2015. Available at: <https://www.youtube.com/watch?v=gQiPUL9pJTk>

¹⁰Report inquiring into the causes and consequences of Kosovo citizens' involvement as foreign fighters in Syria and Iraq, Kosovar Center for Security Studies, 14 April 2015, <http://www.qkss.org/en/Occasional-Papers/Report-inquiring-into-the-causes-and-consequences-of-Kosovo-citizens-involvement-as-foreign-fighters-in-Syria-and-Iraq-408>

train the new generation of leaders

Kosova duket si vendi më i ndikuar në Ballkanin Perëndimor për këtë çështje. Krahasuar me vende të tjera perëndimore, raporti i të rekrutuarve është 8 herë më i lartë se në Francë (16 luftëtarë/100,000 banorë), që është dhe vendi nga ku rekrutohen më shumë luftëtarë të huaj në Siri dhe Irak (Shtuni 2015b).

Analiza:

Ndërkohë që ka një analizë në rritje të marrëdhënieve në publik *online* të ISIS në nivel global, studimi ynë është i pari për sa i përket propagandës *online* të ISIS në Shqipëri.

Edhe pse ka disa studime mbi faktorët nxitës për të bashkuar me ISIS për Shqipërinë, ajo që mbetet e paqartë është mënyrat që përdor strategjia e komunikimit të ISIS për të joshur shqiptarët.

Ndryshe nga grupe të tjera të armatosura të mëparshme, ISIS ka një mënyrë të veçantë dhe suksesshme të propagandës online për të rekrutuar dhe përçarë mesazhet në publik.

Numri total i ndjësve në Tëitter ishte 2 milion dhe 200 mijë vinin nga liga Arabe e Tëitter.

ISIS ka shfrytëzuar rekrutimin dhe radikalizimin online edhe në Ballkanin Perëndimor¹².

Në një seri mesazhesh video Lavdërim Muhaxheri (një nga komandantët kyç të ISIS) thërret shqiptarët për t'ju bashkuar kauzës. Në Qershor 2015, nëpërmjet 20 minuta video, ISIS kërcënon “jo-besimtarët” në Ballkanin Perëndimor nëpërmjet zërit të tre ushtarëve të huaj (dy shqiptarë etnikë dhe një nga Bosnje dhe Hercegovina)¹³.

Siç përmendet në raportet e mëparshme dhe nga analiza e shtypit shfaq se krahasuar me grupe të tjera terroriste, ISIS ka një mjet shtesë shumë të përpunuar që është një strategji me standarte të larta të komunikimit publik nëpërmjet mjeteve të komunikimit *online*.

¹¹The Guardian “Kosovo cuts Pristina water supply over alleged ISIS plot to poison reservoir”, The Guardian, Agency in Kosovo, 11 July 2015. Available at: <http://www.theguardian.com/world/2015/jul/11/kosovo-cuts-pristina-water-supply-over-alleged-isis-plot-to-poison-reservoir>

¹²Meek, G. J. “ISIS aims new recruitment video at Balkan Muslims” ABC News, 5 June 2015. Available at: <http://abcnews.go.com/International/isis-aims-recruitment-video-balkan-muslims/story?id=31554167>

¹³Plesch, V. “Kosovo to stem flow of ISIL recruits” Aljazeera America, 23 September 2014. Available at: <http://america.aljazeera.com/articles/2014/9/23/kosovo-tries-to-stemflowofisilrecruits.html>

Studiesit¹⁴ evidentojnë tre elemente që përforcojnë strategjinë e komunikimit, e para mesazhi për të bashkuar njerëzit (kjo për rekrutimin në perëndim), e dyta mesazhi për të treguar tash e kështu (për të frikësuar vendasit) dhe e treta mesazhi lidhur me ligjin e xhunglës (pasi në ndryshim nga propaganda e organizatave të tjera të konsideruara si terroriste, ata nuk kërkojnë të justifikojnë dhunën, thjesht tregojnë forcën).

Lidhur me elementin e fundit, duhet thënë se rezultatet në terren i japin ISIS një narrativë të thjeshtë e cila përhapet shpejt globalisht¹⁵ për atë pjesë të vogël të popullsisë që është objektivi për t'u rekrutuar.

Një nga strategjitë kyçe të ISIS është të komunikojë në publik nëpërmjet njerëve të vet dhe zërave të tyre. Mesazhet globale janë në mesazhe "zyrtare" të dërguara në dy gjuhët kryesore, anglisht dhe arabisht, ndërsa mesazhet e shenjësuar për vende të caktuara dërgohen në gjuhën e tyre kombëtare.

Një tjetër strategji është komunikimi "informal" ku përfaqësues të ISIS komunikojnë jo në emër të tij, por duke treguar eksperiencat personale (mesazhe individuale).

Mjeti më i përdorur janë rrjetet sociale (Facebook, Tëitter, Instagram).

Në Sqipëri Facebook duket si media më e përdorur për komunikime. Nga sa vërehet, shqiptarët janë një ndër grupet më të shenjësuar për rekrutim nga ISIS, duke përdorur forma të komunikimit si mesazhe video dhe mesazhe specifike vetëm për shqiptarët, ose në raste të tjera për "Muslumanët e Ballkanit Perëndimor".

ISIS ka përdorur të gjitha strategjitë e sipërpërmendura të komunikimit për të tërhequr dhe radikalizuar shqiptarët në Shqipëri dhe Kosovë.

¹⁴Christoph Reuter, "The Professional PR Strategies of ISIS in Syria and Iraq", SPIEGEL ONLINE, 8 Tetor 2014, e aksesuar nga: <http://www.spiegel.de/international/world/the-professional-pr-strategies-of-isis-in-syria-and-iraq-a-995611.html>

¹⁵Darren Katz, "How to Defeat ISIS in the Public Relations War", The Juice from kglobal, 5 Mars 2015, e aksesuar nga: <http://kglobal.com/blog/how-to-defeat-isis-in-the-public-relations-war>

Sugjerime:

- Politikat për pengimin e strategjive të rekrutimit të ISIS në Shqipëri duhet të konsiderojnë një kundër-narrativë dhe jo vetëm politika të ashpra të burgosjes dhe luftrave *online* ndërmjet shteteve dhe individëve radikalë (mbyllja e adresave web të ekstremistive).
- Përballja *online* me propagandën e ISIS duket sikur ka dështuar, pasi sa më shumë adresa web, apo faqe të individëve radikalë mbyllen nga agjensitë ligj-zbatuese, aq më shumë hapen, akoma edhe më të sofistikuara.
- Në vend të harxhimit të burimeve në mjetet *online*, qeveritë duhet të konsiderojnë faktorët *offline* që shtyjnë individët për të kontaktuar dhe komunikuar me ISIS.
- Fokusi duhet të orientohet në faktorët social dhe mënyrat për të integruar individët e radikalizuar *online* në shoqëri.
- Çështja e ISIS ka treguar gjithashtu se rekrutimi nuk është vetëm individual por mbart edhe lidhje komunitare. Shumë individë janë bashkuar me ISIS në grupe shokësh apo familjesh dhe duhen strategji qeveritare për të trajtuar këtë fenomen.
- Nxitja e dhunës dhe urrejtjes online me baze fetare është problematike dhe në besimet e tjera (“katolike” dhe “ortodokse”)

Tiranë, më 13.11.2015

Ky dokument u prodhua si pjesë e inisiativave publike të pjesëmarrësve të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike” dhe u mbështet nga Akademia e Studimeve Politike. Nëpërmjet angazhimit në këto inisiativa, synohet që objektivat e reformave të rëndësishme në vend të transmetohen tek publiku i gjerë dhe në këtë mënyrë, të sigurohet ndërgjegjësimi i duhur për rolin e gjithësecilit prej aktorëve dhe vetë publikut në zbatimin e këtyre detyrimeve dhe standardeve.